



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL PËR MBIKËQYRJEN E
SHËRBIMIT CIVIL

RAPORT
(Përfundimtar)

PËR

INSPEKTIMIN NË LIDHJE ME PROCESIN E RISTRUKTURIMIT

KËSHILLI I QARKUT GJIROKASTËR

Tiranë, Mars 2015

RAPORT

Për kryerjen e inspektimit në lidhje me procesin e ristrukturimit të institucionit, Këshilli i Qarkut Gjirokastrë.

Hyrje

Në muajin janar 2015, Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil mori dijeni se Këshilli i Qarkut Gjirokastrë, me Vendimin nr.1, datë 8.01.2015 *“Për miratimin e strukturës organike, funksioneve dhe pagave të Administratës së Këshillit të Qarkut për vitin 2015 “Ristrukturim”* kishte kryer procesin e ristrukturimit. Disa prej punonjësve ndaj të cilëve është vendosur lirimi nga shërbimi civil për shkak të ristrukturimit të institucionit, e kanë konsideruar aktin administrativ të lirimit të tyre nga shërbimi civil si të kryer në kundërshtim me procedurën e parashikuar në nenin 50 e vijues të Ligjit Nr. 152/2013, *“Për nëpunësin civil”*. Dy prej tyre kërkuan verifikimin e pretendimit të tyre nga Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil.

Për këto arsye, Komisioneri, në mbështjete të nenit 11 pika 1, si dhe të nenit 14, pikat 1 e 2 të Ligjit nr. 152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar, me Vendimin Nr.12, datë 27.02.2015, *“Për kryerjen e inspektimit në lidhje me procesin e ristrukturimit të institucionit, Këshilli i Qarkut Gjirokastrë”*, vendosi kryerjen e inspektimit të përgjithshëm në këtë institucion në disa drejtime, si: lëvizja, transferimi apo lirimi nga shërbimi civil i punonjësve, nëse këto procedura janë bërë sipas parashikimeve të nenit 50 të Ligjit 152/2013 *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar me Ligjin 178/2014 *“Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin nr.152/2013 “Për nëpunësin civil”* si dhe Vendimin nr.171, datë 26.03.2014 *“Për transferimin e përhershëm dhe të përkohshëm të nëpunësve civilë, pezullimin dhe lirimin nga shërbimi civil”* të Këshillit të Ministrave, Kreu III *“Transferimi për shkak të mbylljes dhe ristrukturimit të institucionit”*.

Në zbatim të Vendimit nr.12, datë 27.02.2015, *“Për kryerjen e inspektimit në lidhje me procesin e ristrukturimit të institucionit, Këshilli i Qarkut Gjirokastrë”*, të Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, u ngrit grupi i inspektimit i përbërë nga Zamira Mujali dhe Ilirjan Osmanlliu, të cilët kanë bërë përpunimin e të dhënave dhe kanë përgatitur projektraportin e inspektimit për këtë institucion, të cilin ia kanë dërguar për njohje, me shkresën nr. 213/2, datë 09.04.2015, duke i lënë 5 ditë kohë për të paraqitur observacionet. Pas kësaj, projektraporti është nënshkruar pa vërejtje nga kryetari i Qarkut Gjirokastrë dhe drejtuesi i njësisë së menaxhimit të burimeve njerëzore dhe është administruar në dosjen e mbikëqyrjes.

Qëllimi i inspektimit:

- Monitorimi, kontrolli dhe vlerësimi i zbatimit të Ligjit nr. 152/2013 *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar me Ligjin 178/2014 *“Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin nr.152/2013 “Për nëpunësin civil”* si dhe Vendimin nr.171, datë 26.03.2014 *“Për transferimin e përhershëm dhe të përkohshëm të nëpunësve civilë, pezullimin dhe lirimin nga shërbimi civil”* të Këshillit të Ministrave, Kreu III *“Transferimi për shkak të mbylljes dhe ristrukturimit të institucionit”*.
- Paraqitja para përgjegjësve për administrimin e shërbimit civil, njësisë së burimeve njerëzore dhe titullarit të institucionit, e konstatimeve e fakteve të evidentuara dhe të vlerësuara si parregullsi në lidhje me zbatimin e Ligjit për nëpunësin civil;

- Paralajmërimin e institucionit dhe personave përgjegjës, në rast të konstatimit të parregullsive gjatë zbatimit të Ligjit, duke lënë edhe detyrat dhe rekomandimet përkatëse për përmirësimin e situatës, brenda një afati të arsyeshëm, sipas përcaktimeve të bëra në nenin 15 të Ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil” të ndryshuar.

Objekti i inspektimit

1. Si janë kuptuar e zbatuar dispozitat e Ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil” dhe aktet nënligjore dalë në bazë e për zbatim të tij, në lidhje me procesin e ristrukturimit (*neni 50 i Ligjit 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar me Ligjin 178/2014 “Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin nr.152/2013 “Për nëpunësin civil” si dhe Vendimin nr.171, datë 26.03.2014 “Për transferimin e përhershëm dhe të përkohshëm të nëpunësve civilë, pezullimin dhe lirimin nga shërbimi civil” të Këshillit të Ministrave, Kreu III “Transferimi për shkak të mbylljes dhe ristrukturimit të institucionit”*).
2. Kontrolli i ligjshmërisë së procedurës së ndjekur nga institucioni, Këshilli i Qarkut Gjirokastrë, në lidhje me mënyrën e zbatimit të kërkesave të Ligjit në fjalë, që nga krijimi i komisionit të ristrukturimit i cili shqyrton mundësitë e sistemimit të çdo nëpunësi civil në vendet e lira ekzistuese, ku nëpunësi plotëson kërkesat e posaçme e deri në daljen e vendimit përfundimtar të transferimit i cili është kompetencë e njësisë përgjegjëse.
3. Rregullimin e ligjshmërisë në procesin e ristrukturimit nëse vërehen shkelje të procedurës dhe kushteve të përcaktuara në nenin 50 të Ligjit 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar me Ligjin 178/2014 “Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin nr.152/2013 “Për nëpunësin civil” si dhe Vendimin nr.171, datë 26.03.2014 “Për transferimin e përhershëm dhe të përkohshëm të nëpunësve civilë, pezullimin dhe lirimin nga shërbimi civil” të Këshillit të Ministrave, Kreu III “Transferimi për shkak të mbylljes dhe ristrukturimit të institucionit.
4. Plotësimi i kushteve ligjore të parashikuara në nenin 67 të Ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, në lidhje me statusin e punonjësve dhe nëpunësve aktualë, që do të verifikohet në këto aspekte:
 - Përfshirja e funksionit në shërbimin civil në përputhje me përshkrimin e punës dhe detyrat që realizon ky funksion.
 - Punonjësit ekzistues që janë punësuar në pozicione të shërbimit civil sipas këtij ligji, që janë rekrutuar sipas një procedure pranimit konkurruese, nëpërmjet procedurave të ngjashme me dispozitat e ligjit të mëparshëm, nr.8549, dt.11.11.1999 “Statusi nëpunësit civil” , apo për një periudhë më të vogël se 1 (një) vit;
 - Nëpunës ekzistues që janë të punësuar në pozicione, pjesë e shërbimit civil, sipas këtij ligji, pa kaluar më parë në procedurë formale konkurruese ose që kanë më pak se 1 (një) vit në këto pozicione pune;
 - Rastet e refuzimit të deklarimit të statusit të nëpunësit civil;
 - Si është dokumentuar procedura e ndjekur nga njësia përgjegjëse, në rastin e deklarimit të statusit të punësimit të punonjësve;

Metodologjia e inspektimit

Inspektimi përfshiu verifikimin e procesit të ristrukturimit të Këshillit të Qarkut Gjirokastrë, praktikën e lirimit nga shërbimi civil të nëpunësve që i është shkurtuar pozicioni i punës apo i janë ndryshuar kërkesat e posaçme dhe të përgjithshme, për shkak të ristrukturimit të institucionit bazuar në Vendimin nr.1, datë 08.01.2015 “*Për miratimin e strukturës organike, funksioneve dhe pagave të Administratës së Këshillit të Qarkut për vitin 2015 “Ristrukturim”*”.

Me shkresën Nr. 213, datë 27.02.2015 të Komisioneri Për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, u njoftua institucioni, Këshilli i Qarkut Gjirokastrë për fillimin e inspektimit dhe objektin e tij.

Nga ana e Këshillit të Qarkut Gjirokastrë me shkresën nr.118 Prot, datë 06.03.2015 është përcjellë dokumentacioni i kërkuar nga ana e Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil. Ky dokumentacion është dërguar dhe më parë në rrugë elektronike nga personi i kontaktit i Këshillit të Qarkut Gjirokastrë, shefi i sektorit të personelit, *****.

Në zbatim të programit dhe drejtimit të inspektimit të përcaktuar në Vendimin nr. 12, datë 27.02.2015 të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil u verifikua dhe u trajtua dokumentacioni i mëposhtëm në raport me procedurat ligjore:

- Vendimin nr.1, datë 08.01.2015 i Këshillit të Qarkut Gjirokastrë “*Për miratimin e strukturës organike, funksioneve dhe pagave të Administratës së Këshillit të Qarkut për vitin 2015 “Ristrukturim”*”.
- Vendimin nr.2, datë 20.02.2014 i Këshillit të Qarkut Gjirokastrë “*Për miratimin e strukturës organike, funksioneve dhe pagave të Administratës së Këshillit të Qarkut për vitin 2014*”.
- Rregullore e ndryshuar e Administratës së Këshillit të Qarkut Gjirokastrë për vitin 2015.
- U administruan aktet e deklaramit të statusit për të gjithë nëpunësit e Këshillit të Qarkut Gjirokastrë, të lëshuara nga Njësia e Personelit.
- Formularët e përshkrimit të punës për të gjithë pozicionet e shërbimit civil sipas strukturës aktuale të vitit 2015.
- Listëpagesat e muajit shkurt 2015 të të gjithë punonjësve të institucionit .
- Vendimet e lirimit nga shërbimi civil të ish nëpunësve civilë të Këshillit të Qarkut Gjirokastrë, për shkak të ristrukturimit.
- Urdhëri nr.1/1, datë 09.01.2015 “*Për ngritjen e komisionit të njësisë së menaxhimit të burimeve njerëzore*” .
- Urdhëri nr.2, datë 09.01.2015 “*Për zbatimin e strukturës organike të vitit 2015*”.
- Proces verbali i mbledhjes së Këshillit të Qarkut Gjirokastrë i datës 09.01.2015.
- Urdhëri nr.3, datë 09.01.2015 “*Për emërim në detyra funksionale*”.

Përmbajtja e raportit:

- I. Procesi i deklaramit të statusit të punësimit dhe plotësimi i kushteve ligjore për të përfituar statusin e nëpunësit civil, në përputhje me kërkesat e nenit 67 të Ligjit 152/2013 “*Për nëpunësin civil*” të ndryshuar dhe akteve nënligjore në zbatim të tij.**

1. Situata e administrimit të burimeve njerëzore në momentin e inspektimit .

Ligji nr.152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, vendos rregulla të qarta për mënyrën e administrimit të shërbimit civil, për të gjitha institucionet që hyjnë në fushën e veprimit të tij.

Në nenin 2 të këtij ligji, përcaktohet se ky ligj zbatohet për çdo nëpunës që ushtron një funksion publik në një institucion të administratës shtetërore, institucion të pavarur apo njësi të qeverisjes vendore, por njëkohësisht evidentohen dhe rastet përjashtimore për disa funksione të identifikuar shprehimisht në këtë dispozitë të ligjit.

Këshilli i Qarkut është krijuar dhe funksionon si organ përfaqësues i Qarkut, mbi bazën e Ligjit nr. 8652, datë 31.07.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”, ndryshuar me Ligjin nr. 9208, datë 18.03.2004, i cili në nenet 5 dhe 6 të tij, e përcakton atë si njësi të qeverisjes vendore, e për këtë arsye ky institucion përfshihet në fushën e veprimit të ligjit për nëpunësin civil.

Administrata e Këshillit të Qarkut funksionon mbi bazën e strukturës organizative të miratuar nga Këshilli i Qarkut, sipas parashikimeve të nenit 54 të Ligjit 8652, datë 31.07.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”, ku përcaktohen detyrat dhe kompetencat e Këshillit të Qarkut.

Në rastin konkret, subjekti i inspektimit, funksionon sipas strukturës organizative të miratuar me Vendimin nr. 1, datë 08.01.2015 “Për miratimin e strukturës organike, funksioneve dhe pagave të Administratës së Këshillit të Qarkut Gjirokastrë për vitin 2015” Ristrukturim”, ndërsa në momentin e hyrjes në fuqi të Ligjit 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, datë 26.02.2014, Këshilli i Qarkut Gjirokastrë ka funksionuar sipas strukturës organizative të miratuar me Vendimin nr.2, datë 20.02.2014 “Për miratimin e strukturës organike, funksioneve dhe pagave të Administratës së Këshillit të Qarkut dhe tre Ndërrmarrjeve të Rrugëve Rurale”.

Sipa strukturës së mësipërme, administrata e Këshillit të Qarkut Gjirokastrë kishte gjithsej **38** pozicione pune. Duke patur parasysh klasifikimin e pozicioneve në shërbimit civil, sipas përcaktimeve të nenit 19 të Ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, rezulton se në këtë institucion janë **31** pozicione pune pjesë e shërbimit civil, të cilat ndahen në këto kategori:

- Nëpunës civilë të nivelit të mesëm drejtues janë **4** pozicione pune, të cilat i përkasin pozicionit “Drejtor Drejtorie” dhe “Kryeinspektor”.
- Nëpunës civilë të nivelit të ulët drejtues janë **8** pozicione pune, të cilat i përkasin pozicionit “Përgjegjës sektori/specialist i nivelit të lartë”.
- Nëpunës civilë të nivelit ekzekutiv janë **19** pozicione pune, të cilat i përkasin pozicionit “specialist”.

2. Si është kuptuar dhe zbatuar neni 67 i Ligjit nr.152/2013 “Për nëpunësin civil” i ndryshuar dhe aktet nënligjore në zbatim të tij.

Nisur nga fakti që Këshilli i Qarkut Gjirokastrë është pjesë e shërbimit civil, deklarimi si nëpunës civilë ekzistues për çdo punonjës të këtij institucioni, duhet të bëhet në respektim të kërkesave të përcaktuara në Ligjin nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, neni 67, pikat 3,4 dhe 6, ku përcaktohet në mënyrë të shprehur se:

- *pika 3, “Nëpunësit civilë ekzistues, punonjësit ekzistues, që janë të punësuar në pozicione të shërbimit civil, sipas këtij ligji dhe që janë rekrutuar sipas një procedure pranimi konkurruese, të ngjashme me atë të përcaktuar nga Ligji nr.8549, datë 11.11.1999 “Statusi nëpunësit civil”, apo që janë të punësuar në të njëjtin vend pune për një periudhë jo më të vogël se 1 vit, janë, për shkak të ligjit, nëpunës civilë”;*
- *pika 4 “Nëpunës ekzistues, që janë të punësuar në pozicione pune, pjesë e shërbimit civil, sipas këtij ligji dhe që nuk plotësojnë kushtet e parashikuara në pikën 3 të këtij neni, janë nëpunës civilë në periudhë prove dhe për ta zbatohen dispozitat e nenit 24 të këtij ligji. Periudha e provës fillon nga fillimi i shtrirjes së efekteve të këtij ligji”;*
- *pika 6 “Deklarimi i statusit të punësimit, sipas pikave 1, 3 dhe 4 të këtij neni, bëhet nga njësia përgjegjëse pas verifikimit të procedurës së punësimit”.*

Po kështu, në Vendimin nr. 116, datë 05.03.2014 të Këshillit të Ministrave ”Për statusin e nëpunësve dhe punonjësve aktualë që përfitojnë statusin e nëpunësit civil sipas Ligjit nr. 152/2013 ”Për nëpunësin civil”, Kreu II ”Statusi i nëpunësve të tjerë civilë në institucionet e administratës shtetërore, institucionet e pavarura, bashkitë dhe qarqet”, pika 1, është përcaktuar se: ”Nëpunës civilë”, sipas pikës 3 të nenit 67, janë të gjithë ata nëpunës që kryejnë funksione të shërbimit civil në momentin e fillimit të efekteve të Ligjit nr.152/2013 dhe që janë rekrutuar sipas procedurave konkurruese, përcaktuar nga Ligji nr. 8549, datë 11.11.1999 ”Statusi i nëpunësit civil”.

Këto janë dispozitat bazë që duhet të mbajë parasysh njësia përgjegjëse për të realizuar drejt detyrimin ligjor të deklarimit të statusit të punësimit.

Për të arritur në një konkluzion të saktë lidhur me veprimet e kryera nga njësia e burimeve njerëzore, si njësi përgjegjëse për administrimin e shërbimit civil, nëse veprimet e saj janë kryer në përputhje me kërkesat e ligjit, grupi i inspektimit verifikoi dhe analizoi materialet shkresore që përmbajnë të dhëna lidhur me pozicionet pjesë e shërbimit civil, si organigramën dhe strukturën e institucionit që ka qenë në fuqi në momentin e shtrirjes së efekteve të ligjit (*Vendimi nr. 2, datë 20.02.2014 “Për miratimin e strukturës organike, funksioneve dhe pagave të Administratës së Këshillit të Qarkut dhe tre Ndërrmarrjeve të Rrugëve Rurale”*).

Në përfundim të kësaj analize, statusin e punësimit të punonjesve të këtij institucioni sipas strukturës që ka qenë në fuqi në momentin e shtrirjes së efekteve të Ligjit nr.152/2013 ”Për nëpunësin civil” i ndryshuar mund t`a kategorizojmë në këtë mënyrë:

- a. Nëpunës, të cilët janë rekrutuar sipas procedurave konkurruese, përcaktuar në Ligjin nr. 8549/1999 ”Statusi i nëpunësit civil”.*

Nga analiza e dokumentacionit që na është vënë në dispozicion nga institucioni, Këshilli i Qarkut Gjirokastrë, me shkresën nr.118, datë 06.03.2015 , rezulton se të gjithë punonjësit e punësuar në pozicione pune pjesë e shërbimit civil, përveç një rasti, janë punësuar në respektim të kërkesave të nenit 13 e vijues të Ligjit nr.8549, datë 11.11.1999 ”Statusi i nëpunësit civil”, me procedura konkurimi (30 prej tyre janë emëruar me procedurë konkurimi, nga 31 që janë gjithse pozicione në shërbimin civil).

Nga kqyrja e akteve të administruara dhe përmbajtja e tyre rezulton se janë respektuar procedurat ligjore të kërkuara nga ky ligj. Kështu, është shpallur pozicioni i lirë, është krijuar komiteti *ad-hoc*, ka dalë akti i përzgjedhjes dhe i emërimit si dhe akti i konfirmimit si nëpunës civilë për 26 punonjës dhe 4 nëpunës civilë janë në periudhë prove.

Në respektim të kërkesave të pikës 3 të nenit 67 të Ligjit nr.152/2013 “Për nëpunësin civil” i ndryshuar si dhe pikës 1 të Vendimit nr. 116, datë 05.03.2014 të Këshillit të Ministrave ”Për statusin e nëpunësve dhe punonjësve aktualë që përfitojnë statusin e nëpunësit civil sipas Ligjit nr. 152/2013 ”Për nëpunësin civil”, Kreu II ”Statusi i nëpunësve të tjerë civilë në institucionet e administratës shtetërore, institucionet e pavarura, bashkitë dhe qarqet”, njësia përgjegjëse ka nxjerrë aktet e deklarimit të statusit të nëpunësit për 30 punonjës të administratës të Këshillit të Qarkut (26 punonjës janë konfirmuar si nëpunës civilë dhe 4 të tjerë nëpunës civilë në periudhë prove).

Konkluzion: Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil vlerëson se, Drejtoria e Burimeve Njerëzore, si njësia përgjegjëse, e ngarkuar nga ligji për të formalizuar aktin e deklarimit të statusit, ka vepruar drejt, kur ka nxjerrë aktin e deklarimit të statusit të punësimit për këtë rast.

b. Pozicione pune pjesë e shërbimit civil, të plotësuara me akte të përkohëshme emërimi përpara hyrjes në fuqi të Ligjit nr. 152/2013 “ Për nëpunësin civil ”, i ndryshuar.

Nga analiza e materialeve të verifikuara, rezulton se **1** pozicion pune pjesë e shërbimit civil në këtë institucion (*specialist për kulturën, trashëgiminë kulturore e sportin në sektorin e shërbimeve në varësi administrative nga Drejtoria e Burimeve njerëzore dhe shërbimeve*) është plotësuar me akt emërimi të përkohshëm sipas dispozitave të Ligjit 7961, datë 12.07.1995, i ndryshuar, Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë, duke mos respektuar procedurat e parashikuara në nenin 13 të Ligjit nr. 8549, datë 11.11.1999 “*Statusi i nëpunësit civil*”.

Po nga vetë njësia e burimeve njerëzore të Këshillit të Qarkut Gjirokastër është ndërprerë kjo marëdhënie pune si e lidhur në kundërshtim me dispozitat e ligjit për shërbimin civil.

Duke u nisur nga përmbajtja e pikës 3 dhe 4 të nenit 67 të Ligjit nr. 152/2013 “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar, si dhe nga këqyrja e akteve, rezulton se:

- Në **26** raste nëpunësit civil, kanë një periudhë *më tepër se një vit* në atë pozicion pune. Drejtoria e Burimeve Njerëzore sipas përcaktimeve të nenit 67 pika 3 të Ligjit 152/2013 “*Për nëpunësin civil*” i ndryshuar, ka nxjerrë aktin e deklarimit të statusit të punësimit si nëpunës civilë për të gjitha këto raste.

Punonjësit që kanë përfituar statusin e nëpunësit civil në këtë kategori janë:

***** Drejtor i Drejtorisë së Burimeve Njerëzore;
***** Drejtor i Drejtorisë Ekonomike dhe Planifikimit të Territorit;
***** Drejtor i Drejtorisë së Marrëdhënieve me Jashtë dhe Publikun;
***** Përgjegjës i Sektorit të Personelit;
***** Përgjegjës i Sektorit të Shërbimeve;
***** Përgjegjëse e Sektorit të Programacionit dhe Zhvillimit Rajonal;
***** Përgjegjëse e Sektorit të Planifikimit të Territorit;
***** Përgjegjëse e Sektorit të Buxhetit dhe Financës;

***** Specialist në Sektorin e Personelit;
 ***** Specialiste në Sektorin e Personelit;
 ***** Specialist në Sektorin e Shërbimeve;
 ***** Specialiste në Sektorin e Marrëdhënieve me Jashtë;
 ***** Specialiste në Sektorin e Personelit;
 ***** Specialiste në Sektorin e Marrëdhënieve me Jashtë;
 ***** Specialiste në Sektorin e Programim Zhvillimit Rajonal;
 ***** Specialist në Sektorin e Programim Zhvillimit Rajonal;
 ***** Specialist në Sektorin e Programim Zhvillimit Rajonal;
 ***** Specialist në Sektorin e Programim Zhvillimit Rajonal;
 ***** Specialiste(*inspektore*) në Inspektoriatin Ndërtimor Urbanistik;
 ***** Specialist në Sektorin e Planifikimit të Territorit;
 ***** Specialist në Sektorin e Planifikimit të Territorit;
 ***** Specialist në Sektorin e Planifikimit të Territorit;
 ***** Specialist - kordinator në Sektorin e Shërbimeve;
 ***** Specialist në Inspektoriatin e Mbrojtjes së Tokës;
 ***** Kryeinspektore e Inspektoriatit të Mbrojtjes së Tokës;
 ***** Specialist në Inspektoriatin e Mbrojtjes së Tokës;

Nga përmbajtja e akteve të emërimit, ku përfshihet momenti i fillimit të marrëdhënieve të punës dhe atyre financiare, rezulton se këta punonjës kanë më shumë se një vit që e kryejnë detyrën e tyre funksionale në pozicionet në të cilat janë deklaruar si nëpunës civilë.

Konkluzion: Për këto arsye, Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil vlerëson se Drejtoria e Burimeve Njerëzore, ka vepruar në përputhje me ligjin në lidhje me deklarin e statusit të punësimit si nëpunës civil për këtë kategori punonjësish.

- Në 4 raste, nëpunësit civil ekzistues, janë punësuar në pozicione, pjesë të shërbimit civil, por nuk plotësojnë kushtet e parashikuara në nenit 67 pika 3 të Ligjit 152/2013 “Për nëpunësin civil” i ndryshuar, kanë një periudhë më pak se një vit në atë pozicion pune. Drejtoria e Burimeve Njerëzore sipas përcaktimeve të nenit 67 pika 4 të Ligjit 152/2013 “Për nëpunësin civil” i ndryshuar, ka nxjerrë aktin e deklarin të statusit të punësimit si nëpunës civilë në periudhë prove për të gjitha këto raste.

Punonjësit që kanë përfituar statusin e nëpunësit civil në peridhë prove në këtë kategori janë:

***** Përgjegjëse e Sektorit të Programacion Zhvillimit;
 ***** Specialiste në Sektorin e Planifikimit të Territorit;
 ***** Specialist - Koordinator në Sektorin e Shërbimeve;
 ***** Specialist - inspektor në Inspektoriatin e Ndërtimit;

Nga përmbajtja e akteve të emërimit, ku përfshihet momenti i fillimit të marrëdhënieve të punës dhe atyre financiare, rezulton se këta punonjës kanë më pak se një vit që e kryejnë detyrën e tyre funksionale në pozicionet në të cilat janë deklaruar si nëpunës civilë në periudhë prove.

Konkluzion: Për këto arsye, Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil vlerëson se Drejtoria e Burimeve Njerëzore, ka vepruar në përputhje me ligjin në lidhje me deklarinimin e statusit të punësimit si nëpunës civil në periudhë prove për këtë kategori punonjësish.

Në vijim të raportit, për ato raste të cilat vlerësohen se nga ana e njësisë përgjegjëse është vepruar drejt dhe rastet kanë qenë të qarta, nuk do të flitet hollësisht.

Në ato raste që do të vlerësohet se procesi i transferimit i parashikuar në nenin 50 të Ligjit 152/2013 “Për nëpunësin civil” i ndryshuar; Vendimin nr.171, dt.26.03.2014 “Për transferimin e përhershëm dhe të përkohshëm të nëpunësve civilë, pezullimin dhe lirin nga shërbimi civil” të Këshillit të Ministrave dhe Vendimin nr.142, datë 12.03.2014 “Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura” të Këshillit të Ministrave, është bërë në kundërshtim me kërkesat e ligjit, do të analizohen hollësisht.

II. Procesi i ristrukturimit i Këshillit të Qarkut Gjirokastrë

Kriteret bazë mbi të cilat është bërë vlerësimi i ligjshmërisë së procesit të ristrukturimit (*aktet e lirit të nëpunësve që i është shkurtuar pozicioni i punës dhe aktet e riemërimit të nëpunësve të mbetur pas ristrukturimit që plotësojnë kërkesat e veçanta dhe të përgjithshme për pozicionin e ri të punës sipas përshkrimeve të reja*) të bëra nga ana e njësisë përgjegjëse janë kërkesat e nenit 50 të Ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar si dhe Vendimit nr.142 datë 12.03.2014, “Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura”, të Këshillit të Ministrave dhe Vendimin nr.171, dt.26.03.2014 “Për transferimin e përhershëm dhe të përkohshëm të nëpunësve civilë, pezullimin dhe lirin nga shërbimi civil” të Këshillit të Ministrave dhe konkretisht:

- Përshkrimet e pozicioneve të punës dhe kërkesat e përgjithëshme e të veçanta të këtyre pozicioneve dhe verifikimi i përputhshmërisë së tyre me karakteristikat personale të nëpunësve që janë riemëruar aktualisht në këto pozicione.
- Nëpunësit e riemëruar pas procesit të ristrukturimit të institucionit janë të certifikuar si nëpunës civilë në përputhje me kërkesat e nenit 67 pika 3 dhe 6 të Ligjit 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar dhe në cilin pozicion pune ka qenë secili nëpunës para procesit të ristrukturimit dhe në cilin pozicion është sistemuar pas tij.

1/a *Struktura organizative e Këshillit të Qarkut Gjirokastrë para procesit të ristrukturimit.*

Nga tërësia e materialeve shkresore të vëna në dispozicion (*si në rrugë elektronike dhe me korespondencë zyrtare*) verifikimi i tyre dhe ballafaqimi me ligjin rezultoi se:

Sipas strukturës së mëparshme të miratuar me Vendimin nr. 2, datë 20.02.2014 “Për miratimin e strukturës organike, funksioneve dhe pagave të administratës së Këshillit të Qarkut” të Këshillit të Qarkut Gjirokastrë, numri i përgjithshëm ishte **38** punonjës, nga të cilët **31** pozicione përfshiheshin në fushën e veprimit të ligjit për shërbimin civil dhe struktura e aparatit administrativ të institucionit kishte organizimin e mëposhtëm:

I. Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve, me organikë **1 Drejtor**, në përbërje të së cilës janë **2** sektorë e konkretisht:

1- Sektori për personelin, me organikë **1 përgjegjës sektori dhe 3 specialistë**, gjithsej **4** nëpunës civil.

2- Sektori për shërbimet, me organikë **1 përgjegjës sektori dhe 4 specialistë**, gjithsej **5** nëpunës civil.

II. Drejtoria e Marrëdhënieve me Jashtë, Publikun dhe për Politikat Rajonale të Zhvillimit, me organikë **1 Drejtor**, në përbërje të së cilës janë **2** sektorë e konkretisht:

1- Sektori i Marrëdhënieve me Jashtë, ato Ndërkufitare dhe Publikun, me organikë **1 përgjegjës sektori dhe 2 specialistë**, gjithsej **3** nëpunës civil.

2- Sektori i Programacionit dhe Zhvillimit Rajonal, me organikë **1 përgjegjës sektori dhe 4 specialistë**, gjithsej **5** nëpunës civil.

III. Drejtoria Ekonomike dhe e Planifikimit të Territorit, me organikë **1 Drejtor**, në përbërje të së cilës janë **2** sektorë e konkretisht:

1- Sektori i Buxhetit dhe i Financës, me organikë **1 përgjegjës sektori**, gjithsej **1** nëpunës civil.

2- Sektori i Planifikimit të Territorit, me organikë **1 përgjegjës sektori dhe 4 specialistë**, gjithsej **5** nëpunës civil.

IV. Inspektoriati i Mbrojtjes së Tokës Bujqësore, me organikë **1 përgjegjës sektori dhe 2 specialistë**, gjithsej **3** nëpunës civil.

V. Inspektoriati Ndërtimor Urbanistik, me organikë **2 specialistë**, gjithsej **2** nëpunës civilë

Sa më sipër rezulton se numri i përgjithshëm i nëpunësve civilë është **31 (tridhjetënjë)**, nga të cilët :

- **3 (tre)** Drejtorë (nëpunës civil i kategorisë së mesme drejtuese kategoria II b-1) ;
- **6 (gjashtë)** përgjegjës sektori (nëpunës civil i nivelit të ulët drejtues kategoria III b-1) ;
- **22 (njëzetedy)** specialistë (nëpunës civilë të kategorisë ekzekutive, 20 specialistë kategoria IVa-1 dhe 2 specialistë kategoria IVb).

1/b *Struktura organizative e Këshillit të Qarkut Gjirokastrë pas procesit të ristrukturimit.*

Sipas Vendimin nr.1, datë 08.01.2015 “Për miratimin e strukturës organike, funksioneve dhe pagave të Administratës së Këshillit të Qarkut “Ristrukturim”, që është në fuqi në momentin e inspektimit të përgjithshëm, administrata e Këshillit të Qarkut Gjirokastrë ka gjithsej **15** pozicione pune, nga të cilët **11** pozicione pune në shërbimin civil dhe ka ndryshime të strukturës. Struktura është e organizuar si më poshtë:

I. Sektori për Personelin dhe Shërbimet, me organikë **1(një)** përgjegjës sektori dhe **4(katër)** specialistë;

II. Sektori i Financës dhe Programacion Zhvillimit, me organikë **1(një)** përgjegjës sektori dhe **5(pesë)** specialistë;

Me miratimin e strukturës së re me Vendimin nr. 1, datë 08.01.2015 ”Për miratimin e strukturës organike, funksioneve dhe pagave të Administratës së Këshillit të Qarkut për vitin 2015

”Ristrukturim” të Këshillit të Qarkut Gjirokastrë, në këtë institucion janë **11 pozicione pune**, pjesë e shërbimit civil sipas klasifikimit të mëposhtëm:

- 2 pozicione shef sektori, nëpunës civil i kategorisë së ulët drejtuese, klasa III/b-1;
- 9 pozicione specialist, nëpunës civil i kategorisë ekzekutive, klasa IV/a-1

Nga krahasimi i strukturave arrihen në konkluzionin se institucioni, Këshilli i Qarkut Gjirokastrë ka kaluar një proces rristrukturimi (*konstatohet plotësimi i dy kërkesvet ligjore për të pasur një proces rristrukturimi: shkurtimi i numrit të përgjithshëm të nëpunësve civilë dhe ndryshimi i strukturës organizative*). Në strukturën aktuale nuk ekzistojnë **3 (tre)** Drejtori; **4 (katër)** sektorë e **2 (dy)** inspektoriate, për rrjedhojë është shkurtuar numri i përgjithshëm i nëpunësve civilë nga **31 (tridhjetënjë)** janë aktualisht **11 (njëmbëdhjetë)**, pozicionet që konkretisht i kemi cituar më lart.

- *Respektimi i kërkesave ligjore për përshkrimin e punës.*

Sipas parashikimeve të nenit 50 të Ligjit 152/2013 “Për nëpunësin civil” i ndryshuar; Vendimin nr.171, dt.26.03.2014 “Për transferimin e përhershëm dhe të përkohshëm të nëpunësve civilë, pezullimin dhe lirimimin nga shërbimi civil” të Këshillit të Ministrave dhe Vendimin nr.142, datë 12.03.2014 “Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura” të Këshillit të Ministrave, është njësia përgjegjëse ajo që drejton gjithë procesin nga ana ligjore. Ajo krijon komisionin e rristrukturimit dhe ka detyrimin ligjor për marrjen e vendimit përfundimtar për lirimimin nga shërbimi civil të nëpunësve që i është shkurtuar pozicioni i punës dhe i ka ndryshuar përshkrimi i punës, pas propozimit të bërë nga komisioni i rristrukturimit.

Përshkrimet e reja të punës i kanë paraprirë procesit të rristrukturimit. Sipas pikës 14 “Procedura dhe formati i përshkrimit të punës” të Vendimit nr. 142, datë 12.03.2014 “Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura” të Këshillit të Ministrave, përshkrimet e reja të punës janë bërë sepse ka ndryshuar mënyra e organizimit të Këshillit të Qarkut Gjirokastrë si pasojë e rristrukturimit dhe janë një përmbledhje e misionit, qëllimit të përgjithshëm, detyrave kryesore dhe përgjegjësive kryesore të pozicionit të punës, për shkak se duhet vlerësuar pozicioni i punës në përputhje me detyrat dhe përgjegjësitë e reja (*përshkrimet e reja të punës pasqyrohen në rregulloren e funksionimit të Këshillit të Qarkut Gjirokastrë*). Një numër më i reduktuar nëpunësish civilë do të kryejnë detyrat në funksion të arritjes së misionit për të cilin është krijuar institucioni i këshillit të qarkut. Pra, nëpunësit e emëruar pas procesit të rristrukturimit do të realizojnë detyrat që më parë i kanë realizuar **31 (tridhjetënjë)** nëpunës civilë e për rrjedhojë përzgjedhja e tyre duhej bërë mbi bazën e kërkesave për një nivel më të lartë profesional, me aftësi të mira organizative dhe menaxhuese, si dhe përvojën e duhur për zgjidhjen e problemeve.

Këto rezultojnë se kanë qenë kriteret që janë mbajtur parasysh nga komisioni i rristrukturimit dhe njësia përgjegjëse në marrjen e vendimeve përfundimtare të emërimit në pozicionet e mbetura pas procesit të rristrukturimit.

- *Respektimi i kërkesave ligjore për zbatimin e nenit 50 të Ligjit 152/2013”Për nëpunësin civil”, të ndryshuar.*

Këshilli i Qarkut Gjirokastrë në funksion të procesit të ristrukturimit dhe në zbatim të Vendimit nr.1, datë 08.01.2015 *"Për miratimin e strukturës organike, funksioneve dhe pagave të Administratës së Këshillit të Qarkut për vitin 2015"*, ka miratuar Rregulloren e Ndryshuar të Administratës së Këshillit të Qarkut.

Rregullorja e mësipërme është bazuar në nenin 54 të Ligjit nr. 8652, datë 31.07.2000 *"Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore"*; Ligjin nr.152/2013 *"Për nëpunësin civil"* i ndryshuar; Ligji nr.8485, datë 12.05.1999 Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë; Ligji 9131, datë 08.09.2003 *"Për rregullat e etikës në administratën publike"*. Kjo rregullore ka përcaktuar misionin e Këshillit të Qarkut Gjirokastrë dhe ka përcaktuar se si të bëhet vlerësimi i pozicioneve të mbetura në kushtet aktuale (*përshkrimet e reja të punës sipas formularit të miratuar*) në përputhje me detyrat e përgjegjësitë e reja; detyrat funksionale të sektorëve dhe nëpunësve të tyre.

Nga Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, konstatohet se në tërësi i gjithë procesi i ristrukturimit është kryer në përputhje me ligjin. Vendimet e lirimt si dhe riemërimit të nëpunësve civilë aktualë janë hartuar në përputhje me nenin 50 të Ligjit 152/2013 *"Për nëpunësin civil"* i ndryshuar; Vendimin nr.171, dt.26.03.2014 *"Për transferimin e përhershëm dhe të përkohshëm të nëpunësve civilë, pezullimin dhe lirim nga shërbimi civil"* të Këshillit të Ministrave dhe Vendimin nr.142, datë 12.03.2014 *"Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura"* të Këshillit të Ministrave, më konkretisht:

I.Procedura e ndjekur nga njësia përgjegjëse e burimeve njerëzore në marrjen e vendimit përfundimtar të riemërimit në shërbimin civil të nëpunësve pas ristrukturimit të institucionit, komenti ligjor dhe konkluzionet për secilin rast.

Me urdhërin nr. 3, datë 09.01.2015 të Kryetarit të Këshillit të Qarkut Gjirokastrë *"Për emërim në detyra funksionale"*, dalë në bazë e për zbatim të Vendimit të Këshillit të Qarkut nr. 1, datë 08.01.2015 *"Për miratimin e strukturës organike, funksioneve dhe pagave të Administratës së Këshillit të Qarkut për vitin 2015"*; nenit 50 të Ligjit 152/2013 *"Për nëpunësin civil"* i ndryshuar; Vendimin nr. 171, dt.26.03.2014 *"Për transferimin e përhershëm dhe të përkohshëm të nëpunësve civilë, pezullimin dhe lirim nga shërbimi civil"* të Këshillit të Ministrave dhe Vendimin nr. 142, datë 12.03.2014 *"Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura"* të Këshillit të Ministrave, është krijuar Komisioni i Ristrukturimit i cili në përputhje me kushtet e reja të shkurtimit të fondeve e për rrjedhojë dhe shkurtimit të personelit, ka bërë propozimet përkatëse para njësisë të personelit për sistemimin në punë të punonjësve më të përshtatshëm.

Për këtë është mbajtur si kriter thelbësor fakti që, gjithë kompetencat dhe funksionet e Këshillit të Qarkut (*të cilat janë të pandryshuara, pasi nuk kemi ndryshime të qëllimit, funksionit apo kompetencave të institucionit*) do të plotësohen me një numër shumë më të pakët punonjësish. Kjo situatë, ka diktuar, shkriren e drejtorive, uljen e nivelit dhe kategorive të vendeve të punës dhe bashkimin e disa funksioneve të mëparshme në një pozicion pune.

Kjo ka sjellë si pasojë edhe konkluzionin e Komisionit të Ristrukturimit, që pas ristrukturimit, në punë do të mbaheshin, punonjësit më të kualifikuar, më cilësorë dhe më me eksperiencë, në mënyrë që të ishin të aftë të përshtateshin me gjëndjen e re të punëve, ku një nëpunës i vetëm duhej të përballojë punën e disa nëpunësve, sipas strukturës së mëparshme.

Nisur nga gjithë sa u tha më sipër, njësia e personelit ka pranuar propozimet e Komisionit të Ristrukturimit dhe ka nxjerrë aktet e riemërimit pas restrukturimit. Nga ana e Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil u konstatua se aktet e emërimit për të gjithë nëpunësit e riemëruar nuk janë individuale (*janë emëruar të gjithë me Urdhërin nr.3; datë 09.01.2013*) dhe në rastet kur ka pasur ulje në detyrë të punonjësve nuk është marrë mendimi i tyre me shkrim për pranimin ose refuzimin e pozicionit të ofruar siç përcaktohet në pikën 19 dhe 20, Kreu III “*Transferimi për shkak të mbylljes dhe restrukturimit të institucionit*” të Vendimit nr.171, datë 26.03.2014, “*Për transferimin e përhershëm dhe të përkohshëm të nëpunësve civilë, pezullimin dhe lirin nga shërbimi civil*”, por këto parregullsi nuk e bëjnë të pavlefshëm vendimin e emërimit, i cili përveç sa sipër, ka dalë në përputhje me kërkesat e nenit 50 të Ligjit 152/2013 “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar; Vendimin nr.171 datë 26.03.2014, “*Për transferimin e përhershëm dhe të përkohshëm të nëpunësve civilë, pezullimin dhe lirin nga shërbimi civil*”, të Këshillit të Ministrave, Kreu III “*Transferimi për shkak të mbylljes dhe restrukturimit të institucionit*” dhe Vendimin nr.142, datë 12.03.2014 “*Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura*” të Këshillit të Ministrave.

1. *****, me Urdhërin nr.3, datë 09.01.2015 është emëruar, në detyrën e përgjegjës të sektorit të personelit dhe shërbimeve (*nëpunës civil i nivelit të ulët drejtues, kategoria IIIb-1*). Më parë nëpunësi ka qenë me detyrë Drejtor i Drejtorisë së Burimeve Njerëzore (*emëruar me Urdhërin nr.14, datë 14.02.2012 dhe akti i deklarimit të statusit i datës 16.06.2014; kategoria IIB-1*). Nëpunësi ***** plotëson kërkesat e posaçme (*arsimi i lartë shkenca shoqërore juridike, mbi 10 vjet në pozicione menaxhuese drejtimi*) dhe të përgjithshme sipas formularit të përshkrimit të punës. Nëpunësi në fjalë ka pasur përparësi në emërim, për arsye se më parë ka ushtruar funksionet e drejtorit.
2. *****, me Urdhërin nr.3, datë 09.01.2015 është emëruar në detyrën e përgjegjës të Sektorit të Financës dhe Programacion-Zhvillimit (*nëpunës civil i nivelit të ulët drejtues, kategoria IIIb-1*). Më parë nëpunësi ka qenë me detyrë Drejtor i Drejtorisë Ekonomike dhe Planifikimit të Territorit (*emëruar me Urdhërin nr.38/1, datë 24.07.2012 dhe akti i deklarimit të statusit i datës 16.06.2014; kategoria IIB-1*). Nëpunësi ***** plotëson kërkesat e posaçme (*arsimi i lartë shkenca shoqërore ekonomike, mbi 10 vjet në pozicione menaxhuese drejtimi*) dhe të përgjithshme sipas formularit të përshkrimit të punës edhe pse sektori ku është emëruar përgjegjës, në funksionin e tij ka të bashkuara funksionet e Sektorit të Financës me ato të Programacion-Zhvillimit gjë që e ndërlikon punën. Ky nëpunës ka eksperiencën e duhur për të drejtuar këtë sektor, pasi para restrukturimit ka patur funksionin e Drejtorit të Drejtorisë Ekonomike dhe Planifikimit të Territorit, me funksione të ngjashme.
3. *****, me Urdhërin nr.3, datë 09.01.2015 është emëruar në detyrën e specialistes për zbatueshmërinë ligjore në Sektorin e Personelit dhe Shërbimeve (*nëpunës civil i nivelit ekzekutiv, kategoria IVA-1*). Më parë ka qenë nëpunëse civile e nivelit ekzekutiv me detyrë specialiste për problemet ligjore në Sektorin e Marrëdhënieve me Jashtë ato Ndërkufitare dhe Publikun (*emëruar rregullisht me Urdhërin nr.15/1, datë 16.02.2001 dhe akti i deklarimit të statusit i datës 16.06.2014; kategoria IVA-1*), në varësi administrative

nga ish Drejtoria e Marrëdhënieve me Jashtë, Publikun dhe për Politikat Rajonale të Zhvillimit.

Nëpunësja ***** plotëson kërkesat e posaçme (*arsimi i lartë shkenca shoqërore juridik, mbi 10 vjet në pozicion pune specialist jurist*) dhe të përgjithshme sipas formularit të përshkrimit të punës. Pas ristrukturimit nuk ekziston më Sektori i Marrëdhënieve me Jashtë ato Ndërkufitare dhe Publikun dhe funksionet e saj i kanë kaluar Sektorit të Personelit dhe Shërbimeve. Meqënëse specialistja plotësonte kërkesat specifike të këtij pozicioni të krijuar si pasojë e ristrukturimit, ajo është emëruar nga njësia përgjegjëse si specialiste, për zbatueshmërinë ligjore në Sektorin e Personelit dhe Shërbimeve.

4. *****, me Urdhërin nr.3, datë 09.01.2015 është emëruar në detyrën specialiste për arkivën, protokollin, shtypshkrimet në sektorin e personelit dhe shërbimeve (*nëpunës civil i nivelit ekzekutiv, kategoria IVa-1*). Më parë ka qënë nëpunëse civile e nivelit ekzekutiv me detyrë specialiste për statistikën, standartet e korrektuara të akteve të këshillit të qarkut në sektorin e personelit (*emëruar rregullisht me Urdhërin nr.15, datë. 16.02.2001 dhe akti i deklarimit të statusit i datës 16.06.2014; kategoria IVa-1*) në varësi administrative nga ish Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve.

Nëpunësja ***** plotëson kërkesat e posaçme (*arsimi i lartë shkenca shoqërore mësuesi, mbi 10 vjet në pozicion pune specialist*) dhe të përgjithshme sipas formularit të përshkrimit të punës; Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve nuk ekziston dhe sektori i personelit në të cilin ishte punonjësja është bashkuar me atë të shërbimeve, pra funksionet e kësaj drejtorie në strukturën e re i kryen sektori i personelit dhe i shërbimeve. Meqënëse kjo nëpunëse plotësonte kërkesat specifike të këtij pozicioni të krijuar si pasojë e ristrukturimit, ajo është emëruar nga njësia përgjegjëse (*organi kompetent për nxjerrjen e vendimit përfundimtar të emërimit*) si specialiste për protokoll arshivën, magazinën dhe shtypshkrimet në sektorin për personelin dhe shërbimet.

5. *****, me Urdhërin nr.3, datë 09.01.2015 është emëruar në detyrën e inspektorit për mbrojtjen e tokës bujqësore për rrethet Gjirokastrë, Tepelenë dhe Përmet në sektorin e personelit dhe shërbimeve (*nëpunës civil i nivelit ekzekutiv, kategoria IVa-1*). Më parë ka qënë nëpunëse civile e nivelit të mesëm drejtues, me detyrë Drejtor i Drejtorisë së Marrëdhënieve me Jashtë, Publikun dhe Politikat Rajonale të Zhvillimit (*emëruar rregullisht pas procedurave konkurruese, me Urdhërin nr.45, datë 24.07.2012 dhe akti i deklarimit të statusit i datës 16.06.2014; kategoria Iib-1*).

Nëpunësja ***** plotëson kërkesat e posaçme (*arsimi i lartë dega agronomi; mbi 5 vjet përvojë pune në profil*) dhe të përgjithshme sipas formularit të përshkrimit të punës; me strukturën e re është shkrirë Inspektoriati i Mbrojtjes së Tokës Bujqësore dhe funksionet e tij është parashikuar të kryhen nga një inspektor i vetëm për mbrojtjen e tokës bujqësore për rrethet Gjirokastrë, Tepelenë dhe Përmet në sektorin e personelit dhe shërbimeve.

6. *****, me Urdhërin nr.3, datë 09.01.2015 është emëruar në detyrën specialist për infrastrukturën urbane dhe emergjencat civile në sektorin e personelit dhe shërbimeve (*nëpunës civil i nivelit ekzekutiv, kategoria IVa-1*). Më parë ka qënë nëpunës civil i nivelit të ulët drejtues, me detyrë përgjegjës i sektorit të personelit (*emëruar rregullisht, nëpërmjet procedurave të konkurimit me Urdhërin nr. 44, datë 24.07.2012 dhe akti i*

deklarimit të statusit i datës 16.06.2014; kategoria IIIb-1) në varësi administrative nga ish Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve.

Nëpunësi ***** plotëson kërkesat e posaçme (*arsimi i lartë shkencë shoqërore ekonomike, mbi 5 vjet në pozicione të së njëjtës fushë*) dhe të përgjithshme sipas formularit të përshkrimit të punës. Në strukturën e re janë bashkuar sektori i shërbimeve me atë të personelit dhe ky nëpunës ka pasur përparësi në emërim, për arsye se më parë ka drejtuar sektorin e personelit në pozicionin e përgjegjës dhe ka njohuritë e mjaftueshme për të kryer këtë detyrë.

7. ***** , me Urdhërin nr.3, datë 09.01.2015 është emëruar në detyrën e specialistes për projektet e agrobiznesit, turizmit, mjedisit dhe marrëdhënieve ndërkufitare në sektorin e financës dhe programacion zhvillimit (*nëpunës civil i nivelit ekzekutiv, kategoria IVa-1*). Më parë ka qënë nëpunës civile e nivelit të ulët drejtues, me detyrë përgjegjëse e sektorit të Marrëdhënieve me Jashtë, Publikun dhe ato Ndërkufitare (*emëruar rregullisht, nëpërmjet procedurave të konkurimit me urdhërin nr.15, datë.14.03.2012 dhe akti i deklarimit të statusit i datës 16.06.2014;kategoria IIIb-1*), në varësi administrative nga ish Drejtoria e Marrëdhënieve me Publikun dhe Politikat Rajonale të Zhvillimit.

Nëpunësja ***** plotëson kërkesat e posaçme (*arsimi i lartë shkencë shoqërore ekonomike*) dhe të përgjithshme sipas formularit të përshkrimit të punës. Funksionet e sektorit të marrëdhënieve me jashtë, ato ndërkufitare dhe publikun që ka drejtuar kjo nëpunës në pozicionin përgjegjëse sektori, në strukturën e re do të kryhen nga punonjësja ***** , tani në pozicionin specialist për projektet agrobiznes, turizëm dhe marrëdhënie ndërkufitare në Sektorin e Financës dhe Programacion Zhvillimit.

8. ***** , me Urdhërin nr.3, datë 09.01.2015 është emëruar në detyrën e specialistes për arkivën e urbanistikës dhe marrëdhëniet për projektet me njësitë e qeverisjes vendore në sektorin e financës dhe programacion zhvillimit (*nëpunës civil i nivelit ekzekutiv, kategoria IVa-1*). Më parë ka qënë nëpunës civile e nivelit të ulët drejtues, me detyrë përgjegjëse e Sektorit të Planifikimit të Territorit (*emëruar me Urdhërin nr.43, datë.24.07.2012 dhe akti i deklarimit të statusit i datës 16.06.2014; kategoria IIIb-1*), në varësi administrative nga ish Drejtoria Ekonomike dhe e Planifikimit të Territorit.

Nëpunësja ***** ka plotësuar kërkesat e posaçme vendit të ri të punës (*arsimi i lartë inxhinieri ndërtimi, mbi 5 vjet përvojë pune*) dhe ato të përgjithshme sipas formularit të përshkrimit të punës, gjë që justifikon mbajtjen e saj në pozicionin specialiste për arkivin e urbanistikës, marrëdhëniet me projektet me njësitë e qeverisjes vendore në Sektorin e Financës dhe Programacion Zhvillimit.

9. ***** , me Urdhërin nr.3, datë 09.01.2015 është emëruar në detyrën e specialistes për mbajtjen e llogarive kontabël në sektorin e financës dhe programacion zhvillimit (*nëpunës civil i nivelit ekzekutiv, kategoria IVa-1*). Më parë ka qënë nëpunës civile e nivelit të ulët drejtues, me detyrë përgjegjëse e Sektorit të Buxhetit dhe Financës (*emëruar me Urdhërin nr.42, datë.25.09.2007 dhe akti i deklarimit të statusit i datës 16.06.2014;kategoria IIIb-1*), në varësi administrative nga ish Drejtoria Ekonomike dhe e Planifikimit të Territorit.

Nëpunësja ***** plotëson edhe kërkesat epërgjithshme dhe ato të posaçme të vendit të ri të punës (*arsimi i lartë ekonomik, mbi 5 vjet përvojë pune*) gjë e cila justifikon

riemërimin e saj në pozicionin specialiste për mbajtjen e llogarive kontabël në Sektorin e Financës e Programim Zhvillimit.

10. *****, me Urdhërin nr.3, datë 09.01.2015 është emëruar në detyrën e specialistes për problemet e arsimit, shëndetësisë dhe trashëgimisë kulturore në sektorin e financës dhe programacion zhvillimit (*nëpunës civil i nivelit ekzekutiv, kategoria IVa-1*). Më parë ka qënë nëpunëse civile e nivelit të ulët drejtues, me detyrë përgjegjëse e Sektorit të Programacionit dhe Zhvillimit Rajonal (*emëruar me Urdhërin nr.39, datë.24.07.2012 dhe akti i deklarimit të statusit i datës 16.06.2014;kategoria IIIb-1*), në varësi administrative nga ish Drejtoria e Marrëdhënieve me Jashtë, Publikun dhe për Politikën Rajonale të Zhvillimit.
- Nëpunësja ***** plotëson kërkesat e përgjithëshme dhe ato të posaçme (*arsimi i lartë mësuesi, mbi 5 vjet përvojë pune*) sipas formularit të përshkrimit të punës; sektori i programacion zhvillimit rajonal të cilin drejtonte punonjësja nuk ekziston në strukturën e re dhe funksionet e tij do të kryhen po nga kjo nëpunëse, tashmë në pozicionin e specialistes për problemet e arsimit, shëndetësisë dhe trashëgimisë kulturore në sektorin e financës dhe programacion zhvillimit.
11. *****, me Urdhërin nr.3, datë 09.01.2015 është emëruar në detyrën specialist për marrëdhëniet me publikun, shoqatat joqeveritare dhe shtresat në nevojë në sektorin e financës dhe programacion zhvillimit (*nëpunës civil i nivelit ekzekutiv, kategoria IVa-1*). Më parë ka qënë nëpunës civil i nivelit të ulët drejtues, me detyrë përgjegjës i sektorit të shërbimeve (*emëruar me Urdhërin nr.40, datë.24.07.2012 dhe akti i deklarimit të statusit i datës 16.06.2014; kategoria IIIb-1*), në varësi administrative nga ish Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe e Shërbimeve.
- Nëpunësi ***** plotëson kërkesat e përgjithëshme e të posaçme të vendit të punës (*arsimi i lartë shkenca shoqërore, mbi 5 vjet përvojë pune*) sipas formularit të përshkrimit të punës; është bashkuar sektori i shërbimeve me atë të personelit dhe nëpunësi ka pasur përparësi në emërim për arsye se më parë ka drejtuar sektorin e shërbimeve në pozicionin e përgjegjësit dhe ka ushtruar më shumë përgjegjësi administrimi dhe organizimi, për më tepër tani në pozicionin e specialistit ushtron disa funksione që kryente më parë.

Sa sipër konstatohet se, kriteret e ndjekura (*formularët e përshkrimit të punës*) nga komisioni i ristrukturimit dhe njësia përgjegjëse, bazuar në kompetencat ligjore të parashikuara në nenin 50 të Ligjit 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar; Vendimin nr.171 datë 26.03.2014, “Për transferimin e përhershëm dhe të përkohshëm të nëpunësve civilë, pezullimin dhe lirin nga shërbimi civil”, të Këshillit të Ministrave, Kreu III “Transferimi për shkak të mbylljes dhe ristrukturimit të institucionit” dhe Vendimin nr.142, datë 12.03.2014 “Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura” të Këshillit të Ministrave, në nxjerrjen e vendimit përfundimtar të emërimit, kanë qënë në funksion të mënyrës së re të organizmit të Këshillit të Qarkut Gjirokastrë si pasojë e ristrukturimit, realizimit të misionit, qëllimit të përgjithshëm, detyrave dhe përgjegjësi kryesore. Për këtë arsye është vendosur që nëpunësit që janë mbajtur dhe riemëruar të kenë një nivel të lartë profesional, të kenë aftësi organizative, menaxhuese, të kenë përvojë në zgjidhjen e problemeve (*është konkluduar nga komisioni i ristrukturimit dhe njësia përgjegjëse që ish*

drejtorët dhe ish përgjegjësit e sektorëve i plotësojnë kriteret e mësipërme për të realizuar të njëjtin mision të institucionit , tani me një numër shumë të reduktuar nëpunësish).

II. Procedura ligjore e ndjekur nga njësia përgjegjëse e burimeve njerëzore në marrjen e vendimit përfundimtar të lirimimit nga shërbimi civil i nëpunësve që i është shkurtuar pozicioni i punës për shkak të ristrukturimit të institucionit, komenti ligjor dhe konkluzionet për secilin rast.

Me urdhërin nr. 2, datë 09.01.2015 të Kryetarit të Këshillit të Qarkut Gjirokastrë, krahas implementimit të Urdhërit nr. 3 dt. 09.01.2015 për riemërimet pas ristrukturimit, ka filluar edhe zbatimi i procedurave ligjore për lirimimin e nëpunësve nga shërbimi civil vendet e punës të të cilëve kanë pësuar shkurtim apo riorganizim.

Në këtë kuadër, njësia përgjegjëse, bazuar në vendimin nr.1, datë 08.01.2015 "Për miratimin e strukturës organike, funksioneve dhe pagave të Administratës së Këshillit të Qarkut për vitin 2015 "Ristrukturim"; Urdhërin nr. 2, datë 09.01.2015 të Kryetarit të Këshillit të Qarkut Gjirokastrë ; nenin 50 të Ligjit 152/2013 "Për nëpunësin civil" i ndryshuar; Vendimin nr. 171, dt.26.03.2014 "Për transferimin e përherëshëm dhe të përkohshëm të nëpunësve civilë, pezullimin dhe lirimimin nga shërbimi civil" të Këshillit të Ministrave dhe Vendimin nr. 142, datë 12.03.2014 "Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura" të Këshillit të Ministrave.

Nga Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil u konstatua se të gjitha aktet e lirimimit të nxjerra nga njësia përgjegjëse kanë dalë në përputhje me kërkesat e nenit 50 të Ligjit 152/2013 "Për nëpunësin civil", i ndryshuar; Vendimin nr. 171 datë 26.03.2014, "Për transferimin e përherëshëm dhe të përkohshëm të nëpunësve civilë, pezullimin dhe lirimimin nga shërbimi civil" të Këshillit të Ministrave, Kreu III "Transferimi për shkak të mbylljes dhe ristrukturimit të institucionit" dhe Vendimin nr. 142, datë 12.03.2014 "Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura" të Këshillit të Ministrave, konkretisht si më poshtë:

- I. *****, ish nëpunës civil e nivelit ekzekutiv me detyrë specialist për botimet, informatizimin, prokurimet dhe blerjet me vlera të vogla në sektorin e Programacionit dhe Zhvillimit Rajonal (*kategoria IVa-1*), në varësi administrative nga ish Drejtoria e Marrëdhënieve me Jashtë, Publikun dhe për Politikat Rajonale të Zhvillimit, me Vendimin nr.8 datë 09.01.2015, është liruar nga shërbimi civil. Funksionet që më parë kryente sektori i Programacionit dhe Zhvillimit Rajonal, në varësi administrative nga ish Drejtoria e Marrëdhënieve me Jashtë, Publikun dhe për Politikat Rajonale të Zhvillimit, aktualisht me strukturën e re, kryhen nga sektori i financës e programacion zhvillimit. Një nga detyrat e punonjësit *****, përveç të tjerave ushtrohen nga shefi i sektorit të financës e programacion zhvillimit (*ka ndryshim të kategorisë dhe klasës së pozicionit të punës nga IVa-1 që ishte në strukturën paraardhëse është IIIb-1*). Pra pozicioni i punës i punonjësit në fjalë, nuk ekziston në strukturën e re të miratuar me Vendimin nr.1, datë 08.01.2015 "Për miratimin e strukturës organike, funksioneve e pagave të Administratës së Këshillit të Qarkut për vitin 2015 "Ristrukturim" të Këshillit të Qarkut Gjirokastrë.

2. *****, ish nëpunës civil e nivelit ekzekutiv me detyrë specialist për zbatimin e programeve të investimeve të vogla në sektorin e Programacionit dhe Zhvillimit Rajonal (*kategoria IVa-1*), në varësi administrative nga ish Drejtoria e Marrëdhënieve me Jashtë, Publikun dhe për Politikat Rajonale të Zhvillimit, me Vendimin nr.7, datë 09.01.2015, është liruar nga shërbimi civil. Konstatohet se në strukturën e re, nuk ekziston as drejtoria dhe as sektori në të cilin punonte punonjësi *****. Funkcionet e ish sektorit të programacion zhvillimit rajonal i kanë kaluar sektorit të financës e programacion zhvillimit. Në strukturën aktuale, për këtë pozicion pune kanë ndryshuar kërkesat e posaçme të cilat ish punonjësi në fjalë nuk i plotëson (*kërkohet arsimi i lartë ekonomik, ndërsa ***** është me arsim zooteknik*).
3. ***** ish nëpunës civil e nivelit ekzekutiv, me detyrë specialist për programimin dhe kordinimin e zbatimit të projekteve rajonale për mjedisin dhe infrastrukturën në arsim e shëndetësi në sektorin e Programacionit dhe Zhvillimit Rajonal (*kategoria IVa-1*), në varësi administrative nga ish Drejtoria e Marrëdhënieve me Jashtë, Publikun dhe për Politikat Rajonale të Zhvillimit, me Vendimin nr.6, datë 09.01.2015, është liruar nga shërbimi civil. Konstatohet se në strukturën e re, nuk ekziston as drejtoria dhe as sektori në të cilin punonte punonjësi *****. Funkcionet e ish sektorit të programacion zhvillimit rajonal, i kanë kaluar sektorit të financës e programacion zhvillimit dhe ushtrohen nga specialisti për problemet arsim, shëndetësi, trashëgimi kulturore. Edhe për këtë pozicion pune, në strukturën aktuale kanë ndryshuar kërkesat e posaçme, të cilat ky punonjës nuk i plotëson (*kërkohet arsimi i lartë pedagogjik - ndërsa ***** ka mbaruar Institutin Bujqësor, dega veterinari.*)
4. ***** ish nëpunëse civile e nivelit të mesëm drejtues me detyrë kryeinspektore e mbrojtjes së tokës në Inspektoriatin e Mbrojtjes së Tokës Bujqësore (*nuk ekziston më as si strukturë dhe as pozicioni i punës, kategoria III-b*), me Vendimin nr.18, datë 09.01.2015, është liruar nga shërbimi civil. Sipas strukturës së re Inspektoriati i Mbrojtjes së Tokës Bujqësore nuk ekziston më dhe funksionet e tij do të kryhen nga një specialist i vetëm, i nivelit ekzekutiv, kategoria IVa-1 në varësi administrative nga sektori i personelit dhe i shërbimeve. Sipas përshkrimit të ri të punës rezulton se kanë ndryshuar kërkesat e posaçme të cilat ish punonjësja nuk i plotësonte (*kërkohet arsim i lartë agronomi, ndërsa ***** kishte arsimin e mesëm si topografe dhe arsimin e lartë mësuesi*).
5. ***** ish nëpunëse civile e nivelit ekzekutiv me detyrë specialiste për zbatimin e detyrave në përputhje me Ligjin dhe udhëzimet për protokollin, arshivën dhe korespondencën, në sektorin e personelit (*kategoria IVa-1*) në varësi administrative nga ish Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve, me vendimin nr.1, datë 09.01.2015, është liruar nga shërbimi civil. Në strukturën e re nuk ekziston më sektori i personelit me vehte, në përbërje të drejtorisë dhe as vetë Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe e Shërbimeve. Gjithë funksionet e kësaj njësie, i kanë kaluar sektorit të personelit dhe të shërbimeve dhe detyrën që më parë e ushtronte ***** e ushtron specialisti i protokoll-arshivës, magazinës dhe i shtypshkrimeve në sektorin e personelit dhe shërbimeve. Konstatohen ndryshime të strukturës organizative dhe shkurtim i numrit të nëpunësve civilë.

6. ***** ish nëpunës civil e nivelit ekzekutiv me detyrë specialist për problemet ligjore e teknike në sektorin e planifikimit të territorit (*kategoria IVa-1, nëpunës civil në periudhë prove*) në varësi administrative nga ish Drejtoria Ekonomike dhe e Planifikimit të Territorit , me Vendimin nr.10, datë 09.01.2015, është liruar nga shërbimi civil. Në strukturën e re nuk ekziston më sektori i planifikimit të territorit e për rrjedhojë ka shkurtime të pozicioneve të punës të gjithë nëpunësve të këtij sektori, ndër të cilët dhe punonjësi ***** , i cili nuk plotëson kriterin e vjetërsisë. Funkcionin e tërë sektorit të suprimuar e kryen specialisti për arkivin e urbanistikës dhe marrëdhëniet me projektet në sektorin e financës e programacion-zhvillimit, i cili sipas përshkrimit të punës plotëson kërkesat e posaçme dhe të përgjithshme të këtij pozicioni (*kërkesa të posaçme: arsimi i lartë inxhinieri ndërtimi; përvoja mbi 5 vjet (ish nëpunësi ishte në periudhë prove specialist) dhe njohuri të sakta të procedurave administrative profesionale*).
7. ***** ish nëpunës civil e nivelit ekzekutiv me detyrë specialist për menaxhimin e infrastrukturës në sektorin e personelit (*kategoria IVa-1*) në varësi administrative nga ish Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve, me Vendimin nr.4, datë 09.01.2015, është liruar nga shërbimi civil. Sipas strukturës së re kjo njësi nuk ekziston dhe funksionet e saj i kanë kaluar sektorit të personelit dhe të shërbimeve (*ka ndryshime strukturash organizative e për rrjedhojë shkurtime të pozicioneve të punës*). Po kështu konstatohet se ka ndryshime të kërkesave të posaçme për pozicionin e ri të punës (*kërkohej arsimi i lartë ekonomik - kriter i cili nuk plotësohet nga ***** i cili ka arsimin e lartë për mësuesi*) i cili aktualisht ushtrohet nga specialisti për infrastrukturën urbane (*kategoria IVa-1*) në sektorin e personelit dhe shërbimeve.
8. ***** , ish nëpunëse civile e nivelit ekzekutiv me detyrë specialiste për titujt e nderit, stimujt, status dëshmori në sektorin e marrëdhënieve me jashtë ato ndërkufitare dhe publikun (*kategoria IVa-1*) në varësi administrative nga ish Drejtoria e Marrëdhënieve me Jashtë, Publikun dhe për Politikat Rajonale të Zhvillimit, me Vendimin nr. 3, datë 09.01.2015, është liruar nga shërbimi civil. Sipas strukturës së re Drejtoria e Marrëdhënieve me Jashtë, Publikun dhe për Politikat Rajonale të Zhvillimit nuk ekziston më dhe për rrjedhojë nuk ekziston as sektori i marrëdhënieve me jashtë ato ndërkufitare dhe publikun, në të cilin kryente funksionin nëpunësja.
9. ***** , ish nëpunës civil i nivelit ekzekutiv me detyrë specialist për bashkërendimin dhe zbatimin e detyrave me drejtuesit lokal në sektorin e shërbimeve për rrethin e Përmetit (*kordinator-kategoria IVa-1*) në varësi administrative nga ish Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve, me Vendimin nr.14, datë 09.01.2015, është liruar nga shërbimi civil. Drejtoria e mësipërme është organizuar si sektor i personelit dhe i shërbimeve dhe pozicioni që ka pasur ish nëpunësi nuk ekziston në strukturën aktuale si emërtesë. (*Ky rast është shqyrtuar nga Komisioneri Për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil me praktikën nr.158/5. Prot, datë 09.03.2015*).
10. ***** , ish nëpunës civil i nivelit ekzekutiv me detyrë ish specialist për liçensimin në fushën e transportit, emergjencat civile në sektorin e shërbimeve (*kategoria IVa-1*) në

varësi administrative nga ish Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve, me Vendimin nr.9, datë 09.01.2015 është liruar nga shërbimi civil. Sipas strukturës së re nuk ekziston sektori i shërbimeve dhe as pozicioni i punës i nëpunësit të sipërcituar. Funksionet e ish sektorit ku punonte ai, i kanë kaluar sektorit të personelit dhe të shërbimeve sepse ka dhe shkurtime personeli dhe shkurtime strukturash.

Një prej funksioneve që kryente më parë *****, në strukturën aktuale kryhet nga specialisti për infrastrukturën urbane dhe emergjencat civile, në varësi të sektorit të personelit dhe shërbimeve. Po kështu konstatohet se ka ndryshime të kërkesave të posaçme për pozicionin e ri të punës (*kërkohet arsimi i lartë ekonomik, kriter i cili nuk plotësohet nga *****, i cili ka arsimin e lartë për inxhinieri mekanike*) kërkesa të cilat nëpunësi në fjalë nuk i plotëson.

11. *****, ish nëpunës civil i nivelit të ulët drejtues me detyrë specialist për mbrojtjen e tokës në Inspektoriatin e Mbrojtjes së Tokës Bujqësore (*nuk ekziston më as si strukturë dhe as pozicioni i punës, kategoria IV-b*), me Vendimin nr.17, datë 09.01.2015, është liruar nga shërbimi civil. Sipas strukturës së re Inspektoriati i Mbrojtjes së Tokës Bujqësore nuk ekziston si njësi në strukturën e re. Funksionet e tij do të kryhen nga një specialist i nivelit ekzekutiv, kategoria IVa-1 në varësi administrative nga sektori i personelit dhe i shërbimeve. *****, nuk ka plotësuar kërkesat e përgjithshme dhe specifike për pozicionin e ri të punës (*ka kryer detyrën e specialistit në Zyrën e Administrimit e Mbrojtjes së Tokës në Tepelenë, kategoria IV-b*). Pozicioni i ri i punës kërkon më shumë përgjegjësi, sepse detyrat që kanë pasur më parë tre specialistë do të ushtrohen nga një inspektor (*inspektor i mbrojtjes së bujqësore kategoria IVa-1*). Specialisti i kategorisë IVa-1 (*specialist niveli A*), sipas Vendimit nr. 142, datë 12.03.2014, “*Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura*”, të Këshillit të Ministrave, Lidhja 2/2 “*Përshkrimi i përgjithshëm i punës dhe kërkesat për pranimin në çdo klasë*”, është nivel më i lartë se specialisti i kategorisë IV-b (*specialist i nivelit B*), si në kuadrin e formimit profesional (*kërkohen njohuri të thella profesionale*), në zgjidhjen e problemeve (*zgjidhjet e dhëna ndikojnë në punën e kolegëve dhe të njësisë organizative përkatëse*), vendimarrja (*vendimarrja lidhet me identifikimin e alternativave për të përmirësuar procedurat dhe teknikat*), mjedisi menaxherial (*puna e specialistit të këtij niveli ndikon në rezultatet e të gjithë sektorit*).
- Ky rast është shqyrtuar nga Komisioneri Për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil me praktikën nr.168/5 Prot, datë 09.03.2015.
12. *****, ish nëpunëse civile e nivelit ekzekutiv me detyrë specialiste për problemet ligjore e teknike në sektorin e planifikimit të territorit (*kategoria IVa-1*) në varësi administrative nga ish Drejtoria Ekonomike dhe e Planifikimit të Territorit, me Vendimin nr.13, datë 09.01.2015 është liruar nga shërbimi civil. Në strukturën e re nuk ekziston më Drejtoria Ekonomike dhe e Planifikimit të Territorit dhe as sektori i planifikimit të territorit e për rrjedhojë ka shkurtime të pozicioneve të punës të gjithë nëpunësve të këtij sektori, ndër të cilët dhe pozicionit ku punonte *****.
13. *****, ish nëpunës civil i nivelit ekzekutiv me detyrë specialist për problemet e urbanistikës në sektorin e planifikimit të territorit (*kategoria IVa-1*) në varësi

administrative nga ish Drejtoria Ekonomike dhe e Planifikimit të Territorit, me Vendimin nr.12, datë 09.01.2015 është liruar nga shërbimi civil. Në strukturën e re nuk ekziston më Drejtoria Ekonomike dhe e Planifikimit të Territorit dhe as sektori i planifikimit të territorit ku punonte nëpunësi në fjalë, për rrjedhje ka shkurtime të pozicioneve të punës të gjithë nëpunësve të këtij sektori. Funksionet që më parë kryenin 4 (*katër*) specialistë të sektorit të planifikimit të territorit, në strukturën e re i kryen 1(*një*) specialist i nivelit ekzekutiv (*kategoria IVa-1*) për arkivin, urbanistikën, marrëdhëniet me projektet me njësitë e qeverisjes vendore në varësi administrative nga sektori i financës e programacion zhvillimit.

14. ***** , ish nëpunës civil i nivelit ekzekutiv me detyrë specialist për problemet e urbanistikës në sektorin e planifikimit të territorit (*kategoria IVa-1*) në varësi administrative nga ish Drejtoria Ekonomike dhe e Planifikimit të Territorit, me vendimin nr. 11, datë 09.01.2015, është liruar nga shërbimi civil. Në strukturën e re nuk ekziston më Drejtoria Ekonomike dhe e Planifikimit të Territorit dhe as sektori i planifikimit të territorit e për rrjedhje ka shkurtime të pozicioneve të punës të gjithë nëpunësve të këtij sektori, ndër të cilët dhe pozicionit ku punonte ky nëpunës. Funksionet që më parë kryenin 4 (*katër*) specialistë të sektorit të planifikimit të territorit, në strukturën e re i kryen 1(*një*) specialist i nivelit ekzekutiv (*kategoria IVa-1*) për arkivin, urbanistikën, marrëdhëniet me projektet me njësitë e qeverisjes vendore në varësi administrative nga sektori i financës e programacion zhvillimit. Në këtë pozicion është mbajtur ish përgjegjësja e sektorit të planifikimit të territorit ***** e cila plotësonte të gjitha kriteret e përgjithshme e të posaçme për këtë vend pune.
15. ***** , ish nëpunëse civile e nivelit ekzekutiv me detyrë specialiste në zbatimin e projekt-programeve rajonale, bujqësi, blektori, agrobiznes në sektorin e Programacionit dhe Zhvillimit Rajonal (*kategoria IVa-1*), në varësi administrative nga ish Drejtoria e Marrëdhënieve me Jashtë, Publikun dhe për Politikat Rajonale të Zhvillimit, me Vendimin nr.2, datë 09.01.2015, është liruar nga shërbimi civil. Sipas strukturës së re Drejtoria e Marrëdhënieve me Jashtë, Publikun dhe për Politikat Rajonale të Zhvillimit është shkrirë dhe po ashtu sektori i Programacionit dhe Zhvillimit Rajonal në të cilin kryente funksionin nëpunësja. Pozicioni i mësipërm nuk ekziston më në strukturën aktuale. Funksionet që më parë kryenin 4 (*katër*) specialistë të sektorit të Programacionit dhe Zhvillimit Rajonal, në strukturën e re i kryen 1 (*një*) specialist i nivelit ekzekutiv (*kategoria IVa-1*) për projektet agrobiznes, turizëm, mjedis dhe marrëdhënie ndërkuftare në varësi administrative nga sektori i financës e programacion zhvillimit. Për më tepër për këtë pozicion pune janë ndryshuar dhe kërkesat e posaçme të cilat punonjësja nuk i përmbush (*kërkohet që nëpunësi të ketë arsimin e lartë ekonomik, ndërsa ***** ka arsimin e lartë bujqësor, dega veterinar*).
16. ***** , ish nëpunës civil i nivelit ekzekutiv me detyrë specialist për bashkërendimin dhe zbatimin e detyrave me drejtuesit lokal për rrethin e Tepelenë (*kordinator*) në sektorin e shërbimeve (*kategoria IVa-1*) në varësi administrative nga ish Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve, me Vendimin nr.15 datë 09.01.2015, është liruar nga shërbimi civil. Drejtoria e mësipërme në strukturën e re është shkrirë dhe për plotësimin e funksioneve të saj është organizuar një njësi personeli në rang sektori, e cila ka shkurtime

të personelit dhe pakësim të kompetencave. Pozicioni që ka pasur nëpunësi, është shkurtuar dhe nuk ekziston as si emërtesë.

17. *****, ish nëpunës civil i nivelit të ulët drejtues me detyrë specialist për mbrojtjen e tokës bujqësore për rrethin Përmet, në Inspektoriatin e Mbrojtjes së Tokës Bujqësore, me Vendimin nr.16, datë 09.01.2015, është liruar nga shërbimi civil, për shkurtim të vendit të punës. Sipas strukturës së re Inspektoriati i Mbrojtjes së Tokës Bujqësore është shkruar si sektor dhe funksionet e tij do të kryhen vetëm nga një specialist i nivelit ekzekutiv, kategoria IVa-1 në varësi administrative nga sektori i personelit dhe i shërbimeve. Në kuadrin e vlerësimit se cili person do të mbahej në pozicionin e vetëm të mbetur për kryerjen e detyrës së inspektorit për mbrojtjen e tokës bujqësore, është mbajtur parasysh se ky pozicion i mbetur në strukturën e re kërkon më shumë përgjegjësi, sepse detyrat që kanë pasur më parë tre specialistë do të ushtrohen vetëm nga një person dhe për këtë shkak është parashikuar një rritje e nivelit të kategorisë së pozicionit, gjë e cila prezumon se kërkohen eksperiencë më e madhe, njohuri më të thella profesionale dhe një nivel më i lartë përgjegjësie prandaj në këtë pozicion u mbajt ish drejtorja e programacion zhvillimit *****.
18. *****, ka qënë punonjës i emëruar sipas dispozitave të Kodit të Punës, me Urdhërin nr. 55, datë 31.10.2014, në një pozicion pune që i përket shërbimit civil. Këtij punonjësi i është ndërprerë marrëdhënia e punës, sepse nuk ka pasur statusin e nëpunësit civil dhe në strukturën aktuale funksionet e këtij pozicioni pune ushtrohen nga specialisti për problemet arsim, shëndetësi, trashëgimi kulturore (*kategoria IVa-1*) në varësi të sektorit të financës e programacion zhvillimit.
19. *****, ish nëpunës civil i nivelit ekzekutiv me detyrë specialist (*inspektor ndërtimi*) për kontrollin e standarteve teknike në fushën e ndërtimit, rezervave ujore për rrethet Tepelenë, Përmet në Inspektoriatin Ndërtimor e Urbanistik (*kategoria IVa-1*), me Vendimin nr.16, datë 09.01.2015, është liruar nga shërbimi civil. Në strukturën aktuale nuk ekziston më si njësi Inspektoriati Ndërtimor e Urbanistik e për rrjedhojë nuk ekziston më as pozicioni i punonjësit *****.
20. *****, ish nëpunëse civile e nivelit ekzekutiv me detyrë specialist (*inspektore ndërtimi*) për kontrollin e standarteve teknike në fushën e ndërtimit, rezervave ujore për rrethin Gjirokastrë në Inspektoriatin Ndërtimor e Urbanistik (*kategoria IVa-1*), me Vendimin nr.5, datë 09.01.2015, është liruar nga shërbimi civil. Në strukturën aktuale nuk ekziston më Inspektoriati Ndërtimor e Urbanistik e për rrjedhojë nuk ekziston më as pozicioni i punonjëses *****.

III. Analiza e disa parregullsive që lidhen me kuptimin dhe zbatimin jo të drejtë të dispozitave të Ligjit Nr. 152/2013, "Për nëpunësin civil", i ndryshuar, Vendimin nr.171 datë 26.03.2014, "Për transferimin e përhershëm dhe të përkohshëm të nëpunësve civilë, pezullimin dhe lirin nga shërbimi civil", të Këshillit të Ministrave, Kreu III "Transferimi për shkak të mbylljes dhe ristrukturimit të institucionit" dhe Vendimin nr.142, datë 12.03.2014 "Për

përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura” të Këshillit të Ministrave të konstatuara gjatë inspektimit të përgjithshëm në Këshillin e Qarkut Gjirokastrë.

Në kuadër të verifikimit për mënyrën e zbatimit të Ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil kontrolloi gjithë procedurën e krijimit, funksionimit dhe konkluzionet e komisionit të ristrukturimit, prej nga rezultoi: Me Urdhërin nr.1/1, datë 09.01.2015 të titullarit të institucionit, bazuar në nenin 50 pika 3 të Ligjit 152/2013 “Për nëpunësin civil” i ndryshuar, është ngritur komisioni i quajtur “Komisioni i menaxhimit të burimeve njerëzore”, i cili pavarësisht emërimit ka tiparet dhe kompetencat e komisionit të ristrukturimit.

Në këtë drejtim konstatohet se nga ana e institucionit, ka një kuptim jo të drejtë të nenit 50 pika 3 të Ligjit 152/2013 “Për nëpunësin civil” i ndryshuar dhe Vendimit nr.171, datë 26.03.2014 dt.26.03.2014 “Për transferimin e përhershëm dhe të përkohshëm të nëpunësve civilë, pezullimin dhe lirim nga shërbimi civil” të Këshillit të Ministrave, në lidhje me komisionin e ristrukturimit dhe mënyrën e ndërtimit të tij. Këtë e tregon fakti se në përbërjen e tij është përfshirë krejt njësia e menaxhimit të burimeve njerëzore. Sipas vendimit të mësipërm e konkretisht pika 17, KREU III “Transferimi për shkak të mbylljes dhe ristrukturimit të institucionit”, përcaktohet procedura e krijimit të komisionit të ristrukturimit, (citim): “Në rastet e mbylljes apo ristrukturimit, njësia përgjegjëse krijon një komision ristrukturimi, i cili shqyrton mundësitë e sistemimit të çdo nëpunësi civil në vendet e lira ekzistuese dhe propozon transferimin e nëpunësit në një pozicion të lirë të së njëjtës kategori”.

Procedura e ndjekur nga njësia përgjegjëse duke marrë dhe kompetencat e komisionit të ristrukturimit është veprim në kundërshtim me përmbajtjen e nenit 37 pika 1/ a të Ligjit nr. 8485, datë 12.05.1999 Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë, i cili garanton paanshmërinë dhe rrit sigurinë e funksionimit të drejtë të administratës publike (të njëjtët nëpunës që propozojnë si anëtarë të komisionit të ristrukturimit edhe vendosin në cilësinë e anëtarëve të njësisë përgjegjëse). Kjo mangësi, nuk prek thelbin e procesit të ristrukturimit, pasi në tërësi, janë respektuar të gjitha rregullat dhe kërkesat si të nenit 50 të Ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, ashtu dhe të VKM nr. 171, datë 26.03.2014 “Për transferimin e përhershëm dhe të përkohshëm të nëpunësve civilë, pezullimin dhe lirim nga shërbimi civil”, pasi vërehet që në gjithë rastet e trajtuara prej tij dhe propozimet e bëra, si për lirim nga shërbimi civil ashtu dhe për riemërim pas ristrukturimit, janë bërë në përputhje të plotë me kërkesat e ligjit dhe akteve nënligjore, si dhe me cilësitë personale dhe eksperiencën e secilit punonjës.

Urdhëri nr. 3, datë 09.01.20015 “Për emërim në detyra funksionale”, bie ndesh me përcaktimet e nenit 105 të Ligjit 8485, datë 12.05.1999 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë” si dhe nenin 50 pika 3 të Ligjit 152/2013 “Për nëpunësin civil” i ndryshuar dhe Vendimit nr.171, datë 26.03.2014 dt.26.03.2014 “Për transferimin e përhershëm dhe të përkohshëm të nëpunësve civilë, pezullimin dhe lirim nga shërbimi civil” të Këshillit të Ministrave.

Aktet e emërimit duhet të jenë individuale sepse ato krijojnë pasoja juridike për nëpunësin (fillon marrëdhënia juridike dhe ajo financiare) dhe organi që ka kompetencën për të marrë vendimin është njësia përgjegjëse. Në rastin konkret Urdhëri nr.3, datë 09.01.20015 “Për emërim në detyra

funkzionale” ka dalë për të gjithë nëpunësit e riemëruar pas ristrukturimit dhe është marrë nga Kryetari i Këshillit të Qarkut Gjirokastrë.

Riemërimet e nëpunësve civilë në pozicione të një kategorie të barabartë ose më të ulët janë bërë pa marrë paraprakisht deklarimin me shkrim të nëpunësit nëse pranon ose jo detyrën e re, siç përcaktohet përcaktohet në pikën 20, Kreu III “*Transferimi për shkak të mbylljes dhe ristrukturimit të institucionit*” të Vendimit nr.171, datë 26.03.2014, “*Për transferimin e përhershëm dhe të përkohshëm të nëpunësve civilë, pezullimin dhe lirin nga shërbimi civil*” .

Formularët e përshkrimeve të punës nuk janë të nënshkruara nga titullari i institucionit (*në mungesë të sekretarit të përgjithshëm dhe të drejtorit të përgjithshëm*).

Gjithsesi, këto parregullsi nuk çenojnë në tërësi procesin e ristrukturimit. Ky proces ka qenë i kushtëzuar nga Ligji nr.160/2014 “*Për buxhetin e vitit 2015*” dhe në këtë kontekst është dashur të veprohet me shpejtësi për të zbatuar procedurën e ristrukturimit sipas kërkesave ligjore, por dhe respektuar të drejtat e nëpunësve civilë të prekur nga procesi (*janë ndërprerë në tërësi 18 marrëdhënie pune*). Fillimi dhe përfundimi i procesit në një kohë të shpejtë është dhe shkak i lejimit të parregullsive të karakterit objektiv si pasojë e kuptimit të gabuar të Ligjit për shërbimin civil dhe akteve ligjore e nënligjore të dala në bazë e zbatim të tij. Ky ligj ka një zhvillim dinamik dhe implementimi i tij do të kërkojë kohë dhe trajnime të vazhdueshme të cilat do të jenë të domosdoshme për nëpunësit e Këshillit të Qarkut Gjirokastrë.

KONKLUZION:

Nisur nga parregullsitë e konstatuara, të cilat nuk çenojnë ligjshmërinë në tërësi të procesit, sepse mund të konsiderohen si të karakterit objektiv dhe që nuk kanë sjellë vendimmarrje të gabuar, lind domosdoshmëria e korrigjimit të tyre në të ardhmen:

1. Njësia përgjegjëse të marrë vendimin përfundimtar të emërimit, në mënyrë nominale, për secilin nëpunës sipas parashikimeve të nenit 50 pika 3 të Ligjit 152/2013 “*Për nëpunësin civil*” i ndryshuar dhe Vendimit nr.171, datë 26.03.2014 dt.26.03.2014 “*Për transferimin e përhershëm dhe të përkohshëm të nëpunësve civilë, pezullimin dhe lirin nga shërbimi civil*” të Këshillit të Ministrave (*të dalë akti individual i emërimit të çdo nëpunësi dhe ky të administrohet dhe të jetë pjesë e dosjes së personelit*).
2. Akti i deklarimit të statusit për secilin nëpunës civil të administratës së Këshillit të Qarkut Gjirokastrë të formulohet në mënyrë nominale dhe të jetë pjesë e dosjes së personelit (*dosje individuale*).
3. Njësia përgjegjëse të marrë mendimin me shkrim të gjithë nëpunësve të emëruar pas ristrukturimit sipas përcaktimeve të pikës 20, Kreu III “*Transferimi për shkak të mbylljes dhe ristrukturimit të institucionit*” të Vendimit nr.171, datë 26.03.2014, “*Për transferimin e përhershëm dhe të përkohshëm të nëpunësve civilë, pezullimin dhe lirin nga shërbimi civil*” dhe të administrojë atë në dosjen e personelit (*dosje individuale*).
4. Format i përshkrimit të punës për pozicionet e shërbimit civil, të jetë sipas lidhjes 4, bashkëlidhur Vendimin nr.142, datë 12.03.2014 “*Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura*” të Këshillit të Ministrave dhe të nënshkruhen nga nëpunësi civil, eprori direkt

i nëpunësit civil si dhe nga titullari i institucionit(në mungesë të sekretarit të përgjithshëm dhe të drejtorit të përgjithshëm).

KOMISIONERI

Pranvera STRAKOSHA